

# PODING – K

*Përpunim përfundimtare monolit, për dysheme mekanikisht të ngarkuara, të prodhuara në bazë çimentoje, aditivë dhe mbushës të cilësisë së lartë. Përgjigjet në EN 13813 CT-C40-F6.*

## Fusha e aplikimit:

Për dysheme nga të cilat kërkohet rezistencë e lartë abrazive dhe në objekte ku zhvillohet transport i automjeteve të rënda siç janë: depo, frigoriferë, bend-parkime, punëtori, auto-servise, pompa benzine, heliodrome dhe ngjashëm.

## Cilësi:

- Përzierje e ngjyrosur në formë pluhuri;
- Monolite me nënshtresën;
- Mos depërtueshmëri ndaj ujit;
- Karakteristika të larta fiziko-mekanike;
- Jo-toksik;
- Realizim i thjeshtë;
- Rezistencë e shkëlqyer abrazive;
- Dekorativ – mundësi për punim në më tepër nuanca;
- Rezistues në vajra;
- I lehtë për mirëmbajtje;
- Ekonomik;
- Trashësi e shtresës 3-5 mm;

## Karakteristika teknike:

Masë e volumit (i forcuar):	2100 – 2300 kg/m <sup>3</sup>
Hollimi:	Klasi A15 sipas EN 13813
Fortësi në lakim:	>6,0 Mpa
Fortësi në presion:	>40,0 Mpa

## Përgatitje e nënshtresës:

Përzierja për nënshtresën e betonit duhet të përmbajë minimum 300 kg/m<sup>3</sup> çimento dhe duhet të jetë e kompozuar mirë që të shmangët segregacioni (çarja). Përdorimi i aditivëve për reduktimin e ujit në betonin, rekomandohet për tu përfituar raport mes ujit dhe çimentos nën 0,55. Konsistenca e përzierjes së betonit para vendosjes duhet të jetë mes 75 – 100 mm.

## Vendosje:

Poding-K vendoset në dy faza:

a) vendosja e parë bëhet me hedhje të barabartë të 1,5-2,5 kg/m<sup>2</sup>, mbi nënshtresën e betonit. Atëherë kur materiali tërësisht do ta errësojë nuancën si pasojë e thithjes së lagështisë nga betoni, duhet të fillohet me shtypjen dhe rrafshimin në nënshtresën. Përgjatë skajeve të objektit punohet me glet vegla manuale çeliku, ndërsa në sipërfaqen e hapur – në mënyrë makinerike me glet-vegla rrotulluese – të ashtuquajtura “helikopterka” me pllakë metali.

b) Menjëherë pas gletimit të shtresës së parë në mënyrë të barabartë hidhen 1,5 kg/m<sup>2</sup> që kanë mbetur të Poding-K. Sërisht priten që shtresa e re ta absorbojë ujin nga nënshtresa dhe materiali fërkohet në nënshtresën me glet-vegla rrotulluese, të ashtuquajtura “helikopterka”.

Numri i punëtorëve dhe makinat duhet të përshtaten në frontin e hapur për punë, për tu fituar sipërfaqe e punuar në mënyrë të baraspeshuar dhe në të njëjtën kohë.

24-48 orë pas vendosjes së betonit, nevojitet që të priten fuga pune të cilat formojnë fusha prej 6-9 (12) m<sup>2</sup>. Gjerësia e bashkimeve të dilatimit është 4-6 mm, ndërsa thellësia më së paku 1/3 nga trashësia e pllakës së betonit. Fugat punuese mbushen me struko elastike Adingakrill.

Kultivimi i nënshtresës është i njëjtë si të gjitha pllakat e betonit për dysheme. Kultivimi i mirë është tejet i rëndësishëm për tu fituar karakteristikat e projektuara fiziko-mekanike të dyshemesë.

Mirëmbajtja e dyshemesë së realizuar me Poding-K bëhet me atë që në kushte të motit të ftohtë i njëjti duhet të mbrohet nga ngrirja me mbulim me najlon dhe materiale termike (tervull, striopor dhe ngjashëm), e ndërkaq në mot të nxehtë, duhet të mbrohet me mbulim me najlon për tu penguar avullimi i përshpejtuar i ujit nga nënshtresa e betonit.

Temperatura ambientale gjatë realizimit të Poding-K duhet të lëviz në kufijtë prej +5 deri në +35° C.

## Shpenzimi:

3-4 kg/m<sup>2</sup>

## Pastrimi:

Veglat dhe pajisja pastrohen me ujë, menjëherë pas përdorimit.

## Paketimi:

Në ventil thasë prej 25 kg.

## Vendosja në depo:

Në ambalazh origjinal, të mbyllur, në hapësira të thata. Afati i përdorimit 12 muaj.

## Ngjyra në dispozicion:

Gri, e kuqe dhe e gjelbër.

**Rrezik për jetën:** Nevojitet që të shmanget kontakti i prodhimit me lëkurën ose sytë, si dhe thithje e drejtpërdrejtë e komponentës në formë pluhuri. Në rast të kontaktit incidental të prodhimit me lëkurën, duhet të mënjanohet me ujë dhe sapun. Nëse materiali spërkat në sy, nevojitet që ato menjëherë të shpëlahen me shumë ujë dhe të kërkohet ndihmë mjekësore. Nëse gëlltitet, nevojitet të kërkohet ndihmë mjekësore.

**Zjarr:** Poding-K është pluhur që nuk mund të ndizet.

**Pastrimi dhe vendosja në depo:** Pastrimi bëhet me ujë. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas dispozitave dhe rregullativave lokale për atë lloj të mbetjeve.

Rekomandojmë që mënyra e vendosjes dhe sasia e nevojshme të përshtatet në kushtet e objektit, si dhe me përdorim të domosdoshëm të pajisjes përkatëse.